

20131493559

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR „PROJEKTIN PËR NDËRTIMIN E AUTOSTRADËS - AKSI RRUGOR KËRÇOVË - OHËR, QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS EKSPORT - IMPORT TË KINËS DHE NP PËR RRUGË SHTETËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e obligimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua për "Projektin për ndërtimin e autostradës - aksi rrugor Kërçovë - Ohër", që do të lidhet ndërmjet Bankës Eksport - Import të Kinës dhe NP për Rrugë Shtetërore në shumë prej 505 044 966,98 dollarë, nëse NP për Rrugë Shtetërore nuk i plotëson dhe nuk i servison obligimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen në Marrëveshjen për hua që do të lidhet ndërmjet Bankës Eksport - Import të Kinës dhe NP për Rrugë Shtetërore për "Projektin për ndërtimin e autostradës - aksi rrugor Kërçovë - Ohër".

Neni 3

Kushtet dhe mënyra e aktivimit të garancisë nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Letër të garancisë të cilën në emër të Republikës së Maqedonisë e nënshkruan ministri i Financave.

Ministri i Drejtësisë do të japë mendim juridik për vlefshmërinë juridike të Letrës së garancisë nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 4

Tërë obligimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do t'i kryejë NP për Rrugë Shtetërore nga të hyrat që i realizon në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshjen për hua.

Neni 5

Afati i pagesës së huas nga neni 1 i këtij ligji është 20 vite, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vitesh.

Shkalla e kamatës është shkallë fikse e kamatës dhe do të jetë 2% në nivel vjetor për tërë kohëzgjatjen e huas.

Huaja do të paguhet në 30 këste të barabarta gjysmëvjetore që arrijnë për pagesë më 21 janar dhe 21 korrik.

Neni 6

Në afat prej 30 ditësh nga data e lidhjes së Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji, në mjetet e huas do t'i paguhet provizion i njëhershëm Bankës Eksport - Import të Kinës në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Për shumën e mjeteve të patërhequra të huas nga neni 1 i këtij ligji, do t'i paguhet provizion i njëhershëm Bankës Eksport - Import të Kinës në shumë prej 0,25% në nivel vjetor.

Neni 7

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe NP për Rrugë Shtetërore do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.